

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Kaldaja te plota (2 cope)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44621220-7-
Kaldaja me ngrohje qendrore; 45331110-0- Instalime kaldajash;

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lek, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ***Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Korçë***, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë

në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës e fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/entikontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Vlera e kërkuar e xhiros, në masën 40% të fondit limit, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke qenë se objekti i prokurimit përfshin furnizimin, transportin, montimin, vënien në punë dhe testimin e dy kaldajave të plota me sistemet ndihmëse përkatëse. Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve (2023, 2024, 2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 të ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Kërkesa që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos rezultojë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit garanton që operatori ekonomik ushtron aktivitet të qëndrueshëm financiar dhe ka aftësi reale për përmbushjen e detyrimeve kontraktore gjatë zbatimit të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr.285/2021. Furnizimi dhe instalimi i kaldajave me gaz përfshin procese teknike të specializuara që lidhen me impiante termike, sisteme nën presion dhe pajisje me kërkesa të larta sigurie. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të provojë se ka realizuar më parë kontrata të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit, duke garantuar njohuritë teknike dhe eksperiencën e nevojshme për realizimin e kontratësobjektprokurimi.

2.3.2. NS-2: Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtja e tyre. “Kategoria A”

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Ne kete kategori punimesh perfsihien krijimi i nyjeve te reja hidrosanitare dhe lidhja e tyre me rrjetin ekzistues te ujit dhe lidhja gjithashtu me gropen e re septike qe do te perdoret per keto ambiente si dhe montimi i te gjitha pajisjeve hidrosanitare te parashikuara ne projekt.

- O.E fitues duhet te jete i akredituar dhe i miratuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise bazuar ne (VKM nr. 212, datë 16.3.2016“Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”, V.K.M. nr. 833 dt. 18/09/2013 “Per përcaktimin e fushes se pergjegjesise se fushes shteterore te Ministrise se Energjise dhe Industrise”, Vendim nr. 840, datë 27.9.2013 për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të këshillit të ministrave “për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë së energjisë dhe industrisë”, vkm nr.1060 date 23.12.2015 Per miratimin e rregullit teknik “Per paisjet dhe bashkesite nen presion” dhe përcaktimin e listes se standarteve te harmonizuar, VKM nr.1065 date 23.12.2015 Per miratimin e rregullit teknik “Enet e thjeshta nen presion” dhe përcaktimin e listes se standarteve te harmonizuar., VKM nr.425, datë 25.05.1996, Për miratimin e rregullores “Për prodhimin, instalimin dhe shfrytëzimin e rezervuareve të gazit të lëngëzuar të naftës”. VKM nr. 430, datë 26.06.2019 “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të transportueshme nën presion, Urdhër nr. 184, datë 05.07.2005 i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës “Për kushtet dhe normat e projektimit të impianteve, instalimeve dhe paisjeve, që shërbejnë për depozitimin dhe Tregtimin e Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”). O.E fitues me ane te akreditimit dhe miratimit ne MIE paraqet se ka kompetence profesionale dhe teknike pasi ambienti ku do te instalohen keto impiante jane ne ambientet e shkollave dhe ne keto kushte O.E fitues duhet te deshmoje se eshte i kualifikuar per te ofruar siguri te larte. O.E fitues pasi të ketë montuar Impiantin teknologjik nën presion dhe përpara vënies në shfrytëzim duhet të pajisë A.K me certifikatën e konformitetit bazuar ne (V.K.M. nr.1062, datë 23.12.2015 Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion“, dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara) VKM Nr. 1062, datë 23.12.2015, “Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion dhe përcaktimin e standardeve të harmonizuara” (aneksi V) “perpaisjet nën presion nga organe të akredituara dhe miratuara nga Ministria e Infrastukturës dhe Energjisë)
- **NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër,

mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshmeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Perfshihen proceset e punes te nevojshme per riparimin e te gjithë demtimeve dhe ndehryrjeve qe mund te lindin gjate shtrirjes se tubacioneve per furnizimin e radiatoreve me uje te ngrohte.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar. Kërkesa për disponimin e licencës NS-2 “Impiante hidrosanitare dhe mirëmbajtja e tyre”, Kategoria A, është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi kontrata përfshin montimin e kaldajave, rrjeteve të tubacioneve të ujit të ngrohtë dhe impiantit të gazit GLN. Këto punime klasifikohen si punime speciale ndërtimi dhe kërkojnë operatorë ekonomikë të licencuar sipas VKM nr.42, datë 16.01.2008. Disponimi i kësaj licence garanton se operatori ekonomik ka kapacitetet profesionale dhe organizative për realizimin e instalimeve hidromekanike dhe termoteknike sipas standardeve teknike dhe rregullave të sigurisë. Kërkesa për akreditim nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë është vendosur për shkak se objekti përfshin instalimin e sistemeve me gaz GLN dhe pajisjeve nën presion në ambiente arsimore. Bazuar në VKM nr.212, datë 16.03.2016, VKM nr.1060, datë 23.12.2015, VKM nr.1062, datë 23.12.2015 dhe aktet e tjera sektoriale të cituara në DST, operatori ekonomik duhet të dëshmojë kompetencë profesionale në projektimin, montimin, testimin dhe certifikimin e impianteve nën presion. Kjo kërkesë ka si qëllim garantimin e sigurisë së përdoruesve të objekteve arsimore dhe shmangien e rreziqeve që lidhen me funksionimin e impianteve të gazit. Licenca NS-4 kërket pasi gjatë realizimit të instalimit të kaldajave dhe rrjeteve të tubacioneve do të kryhen ndërhyrje në mure, dyshme dhe elementë ndërtimorë ekzistues, të cilat kërkojnë rikthimin e ambienteve në gjendjen fillestare përmes punimeve të rifiniturës, suvatimit, riparimeve lokale dhe lyerjeve. Kjo kategori licence garanton aftësinë e operatorit ekonomik për kryerjen e punimeve ndihmëse të nevojshme për përfundimin e objektit në përputhje me specifikimet teknike.

2.3.3. Dëshmitë për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

- Kamion veteshkarkues (8 deri në 10 ton) cope 1 (nje)**

Shoqeria duhet të disponojë kamion veteshkarkues për arsye se do të kryej grumbullimin dhe transportimin e materialeve ndërtimore si rere, cimento, hekur, dhera të germuara për vendosjen nëntok të rezervuarve të gazit, transporti i rezervuarve të gazit, kaldajave dhe materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e procedurës.

- Betoniere cope 1 (nje)**

Shoqeria duhet të disponojë betoniere për përgatitjen e betonit në cilën do të ankorohen rezervuarët e gazit gjithashtu dhe për rehabilitimin e ambienteve teknike që do të krijohen si pasoje e prishjeve duke e pershtatur me ambientin fillestar.

- Depozite uji cope 1 (nje)**

Perpara dorezimit te punes, sipas regullave te instalimit te impianteve nen presion duhet tu behet prove hidraulike per te provuar hermeticitetin e impiantit prandaj eshte e nevojshme qe shoqeria duhet te jete e pajisur me depozite uji e cila nevojitet ne momentin kur te shkarkohet impianti.

• **Pompe uji** **cope 1 (nje)**

Perpara dorzimit te punes sipas regullave te instalimit te impianteve nen presion duhet tu behet prove hidraulike per te provuar hermeticitetin e impiantit ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria duhet te jete e pajisur me pompe uji per realizimine procedures

• **Vibrator betoni** **cope 1 (nje)**

Per arsye se rezervuaret e gazit sipas projektit jane te ankoruara mbi armature betoni

• **Matrapik** **cope 1 (nje)**

Duke patur parasysh natyren e punes e cila konsiston e hapjen e mureve ekzistues te cilet jane me nje gjeresi 0.8 m deri ne 1 m,prishjen e dysHEMEVE prej betoni apo prej materialeve ndertimi te forta

• **Trapano elektrike** **cope 1 (nje)**

Perhapjen e vrimave ne te cilen do vendosen element lidhes per kapjen sa me te mire te tubave te ujit te grohte/fiohte,gazit apo per pune te tjera te cilt kane te bejne me hapjen e vrimave shoqeria duhet te kete kete pajisje.

• **Saldatrice qe te punoje ne TIG dhe Elektrod** **cope 1 (nje)**

Duke patur parasysh natyren e punes ku rrjeti i tubacioneve te gazit dhe rrjeti I ujit te ngrohte do te punoje nen presion gje e cila ka rrezikshmeri te larte duke ju referuar standarteve kombatre dhe nderkombetare rekomandohet qe saldimet pra bashkimi i tubave te behen saldim me TIG ose Elektrod kjo gje e percaktuar dhe ne projekin teknologjik.

• **Troko** **cope 1 (nje)**

Duke patur parasysh natyren e punes qe ka te bej me prerjen u tobave metalik per tubacionet e gazit dhe tubat e uje te ngrohte dhe rikthimet ka shume prerje dhe per kete arsye duhet troko.

- Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese qe makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera
- Per shoferin/manovratorin duhet te paraqiten dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shenim: Kur mjetet jane marre me qira nga persona fizik te cilat jane ne pronesi te ketyre te fundit, dhe punesohen prane shoqerise si shofer/manovrator nuk ka nevojte te figurojne ne listepagesat perkatese te O.E.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi dhe/ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e meposhtem:

- Lejen e qarkullimit.
- Certifikatat e pronësisë,
- Siguracionin e mjetit.

- Kolaudimin,
- Certifikatë transporti
- Fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënsit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- ose fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes ose huapërdorjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë ose të kenë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Objekti i prokurimit parashikon furnizimin, transportin, shkarkimin, instalimin, montimin, testimin dhe vënien në funksion të sistemit të furnizimit me gaz, duke përfshirë rezervuarët e gazit, rrjetin e tubacioneve, pajisjet e ngrohjes dhe elementët ndihmës të sistemit. Për realizimin e këtyre proceseve kërkohet disponimi i mjeteve dhe pajisjeve teknike specifike, të cilat garantojnë transportin e sigurt të mallrave, instalimin sipas projektit dhe kryerjen e provave teknike të detyrueshme përpara dorëzimit.

Konkretisht:

- **Kamioni vetëshkarkues** kërkohet për transportin dhe shkarkimin e rezervuarëve, kaldajave dhe materialeve ndihmëse të nevojshme për instalimin e sistemit.
- **Betonierja dhe vibratori i betonit** kërkohen për realizimin e bazamenteve ose elementëve mbështetës ku parashikohet vendosja dhe ankorimi i rezervuarëve sipas projektit teknik.
- **Depozita e ujit dhe pompa e ujit** kërkohen për kryerjen e provave hidraulike të impiantit, të cilat janë të domosdoshme për verifikimin e hermeticitetit, rezistencës dhe sigurisë së rrjetit përpara vënies në funksion.

- **Matrapiku dhe trapanoja elektrike** kërkohen për kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme gjatë montimit të pajisjeve dhe rrjeteve, si dhe për realizimin e pikave të fiksimit dhe kalimit të tubacioneve.
- **Saldatricja TIG dhe me elektrodë** kërkohet për realizimin e saldimeve të tubacioneve të gazit dhe elementëve metalikë sipas specifikimeve teknike dhe standardeve të sigurisë.
- **Trokoja** kërkohet për prerjen dhe përpunimin e tubacioneve dhe elementëve metalikë gjatë instalimit të sistemit.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që provon pronësinë ose disponueshmërinë e mjeteve, si dhe kualifikimin e drejtuesve/manovratorëve të tyre, është e nevojshme për të garantuar se operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike reale për realizimin e kontratës sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit dhe brenda afateve të zbatimit.

Autoriteti Kontraktor gjykon se numri dhe lloji i mjeteve të kërkuara janë në raport të drejtë me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe nuk krijojnë kufizime të pajustificuara të konkurrencës, pasi janë minimumi i nevojshëm për realizimin e furnizimit me instalim dhe vënie në punë të objekteve të kontratës.

2.3.4. Në lidhje me fuqinë punëtore operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht një numër prej **15 (pesëmbëdhjetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

- Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të pasqyruar në listëpagesa për muajin e fundit të pajisur me dëshmi kualifikimi nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ish IQT ose ekuivalentet e tij) dhe kontrata e punës vlefshme

➤	Elektriciste	2 (dy)
➤	Hidraulike	2 (dy)
➤	Puntore të thjeshtë	6 (gjashtë)
➤	Specialist Gazi dhe Kaldaje	2 (një)
➤	Manovrator/shofer	1 (një)
- **Për punonjësit specialist Gazi dhe Kaldaje** duhen të jenë të pajisur me Dëshmi Afësie për enet nën presion konkretisht për kaldajat dhe për instalimin e rezervuar me të vogël se 13 m³ GLN kjo gjë konform ligjit 32/2016.
- **Për puntoret e thjeshtë** nuk kërket asnjë dokument kualifikimi përveç prezencës në listpagesa për periudhën e kërkuar dhe kontratën e punës të vlefshme.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesa mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës sipas specifikimeve teknike, standardeve të sigurisë dhe afateve të parashikuara.

Objekti i prokurimit nuk konsiston vetëm në furnizimin e pajisjeve, por edhe në transportin, shkarkimin, instalimin, montimin, testimin dhe vënien në funksion të sistemit të furnizimit me gaz, rezervuarëve, kaldajave dhe rrjeteve përkatëse. Për këtë arsye është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një numër minimal prej 15 punonjësish, të cilët sigurojnë kapacitetin e nevojshëm organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës. Numri minimal i punonjësve është përcaktuar bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e furnizimit dhe përfshin:

- **2 elektrikistë**, të nevojshëm për realizimin e lidhjeve elektrike, instalimin dhe vënien në funksion të pajisjeve elektrike të sistemit;
- **2 hidraulikë**, të nevojshëm për montimin dhe lidhjen e rrjeteve hidraulike, tubacioneve dhe pajisjeve përkatëse;
- **2 specialistë gazi dhe kaldajash**, të nevojshëm për instalimin, testimin dhe vënien në punë të impiantit të gazit dhe pajisjeve nën presion, në përputhje me legjislacionin dhe standardet teknike në fuqi;
- **1 manovrator/shofer**, i nevojshëm për operimin e mjeteve dhe pajisjeve mekanike të përdorura gjatë transportit, shkarkimit dhe vendosjes së pajisjeve;
- **6 punëtorë të thjeshtë**, të nevojshëm për kryerjen e proceseve ndihmëse të transportit, montimit dhe sistemit të elementeve të furnizimit.

Kërkesa që specialistët e gazit dhe kaldajave të jenë të pajisur me Dëshmi Aftësie për enët nën presion, në përputhje me Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, është vendosur për shkak se objekti i kontratës përfshin instalimin dhe vënien në funksion të rezervuarëve të GLN-së dhe kaldajave, të cilat konsiderohen pajisje me risk të lartë dhe kërkojnë personel të certifikuar. Kërkesa për paraqitjen e listëpagesave dhe dokumentacionit përkatës synon të verifikojë disponueshmërinë reale të burimeve njerëzore dhe të shmangë angazhimin formal të personelit pa lidhje efektive me operatorin ekonomik. Autoriteti Kontraktor vlerëson se numri dhe profilet e personelit të kërkuar janë në përpjesëtim të drejtë me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e kontratës dhe përfaqësojnë minimumin e nevojshëm për realizimin me sukses të furnizimit, instalimit dhe vënies në funksion të objektit të prokurimit, pa krijuar kufizime të pajustificuara të konkurrencës.

2.3.5. Shoqeria duhet të ketë në stafin e saj drejtues (në licensën e shoqërisë):

- | | |
|----------------------------|--------|
| ✓ Inxhinier Naftë dhe gazi | 1(një) |
| ✓ Inxhinier Mekanik | 1(një) |

Duke qenë se do të instalohet një sistem i furnizimit me gaz GLN (Gaz i lëngëzuar i Naftës) për të shmangur rreziqet e mundshme në lidhje me kushtet e instalimit të impiantit dhe rezervuarit të gazit duhet **1 (një) Inxhinier Naftë dhe Gazi** i pajisur me certifikatën e lejes profesionale sipas kërkesave të VKM nr. 551, datë 18.06.2015, “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, i ndryshuar. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Mekanik** është e nevojshme pasi objekti i prokurimit përfshin furnizimin dhe vendosjen e kaldajës me gaz, linjave të furnizimit, pajisjeve dhe aksesorëve përkatës, të cilët

në tërësi përbëjnë një implant mekanik. Për realizimin e punimeve sipas standardeve teknike, garantimin e funksionimit të sigurt të implantit dhe mbikëqyrjen profesionale të zbatimit të instalimeve mekanike, prania e këtij specialisti konsiderohet e domosdoshme. Bazuar kjo kërkesë në VKM nr. 759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, me anë të së cilës deklarohet se specialistët e mësipërm janë të disponueshëm për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe do të angazhohen gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e realizimit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike, standardet e sigurisë dhe legjislacionin në fuqi. Objekti i prokurimit përfshin furnizimin, transportin, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të një sistemi furnizimi me GLN (Gaz i Lëngëzuar i Naftës), i cili përbëhet nga rezervuarë të gazit, rrjete tubacionesh, kaldaja dhe pajisje të tjera mekanike dhe teknologjike. Për shkak të karakterit specifik dhe rrezikshmërisë së instalimeve të gazit, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme që operatori ekonomik të disponojë në stafin drejtues të pasqyruar në licencën e shoqërisë specialist si inxhinier Naftë dhe gaz dhe Inxhinierin Mekanik. Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Naftë dhe Gaz është e domosdoshme pasi objekti i kontratës lidhet drejtpërdrejt me instalimin dhe vënien në funksion të impianteve që përdorin GLN, përfshirë rezervuarët e depozitimit, sistemet e shpërndarjes dhe pajisjet ndihmëse. Ky specialist garanton zbatimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë gjatë instalimit, testimit dhe funksionimit të implantit, në përputhje me legjislacionin dhe standardet përkatëse të sektorit të hidrokarbureve. Kjo kërkesë mbështetet në VKM nr. 551, datë 18.06.2015, “Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, si dhe në dispozitat e Ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar. Kërkesa për disponimin e një Inxhinieri Mekanik është e nevojshme pasi objekti i prokurimit përfshin furnizimin dhe instalimin e kaldajave me gaz, rezervuarëve, pajisjeve mekanike, rrjeteve të tubacioneve dhe aksesoreve përkatës, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë një implant mekanik. Ky specialist është përgjegjës për mbikëqyrjen profesionale të proceseve të montimit, kontrollin e përputhshmërisë me projektin teknik dhe garantimin e funksionimit të sigurt dhe efikas të sistemit. Kjo kërkesë mbështetet në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar.

Kërkesa që specialistët e mësipërm të jenë pjesë e stafit drejtues të shoqërisë dhe të deklarohen si të disponueshëm për realizimin e kontratës synon të garantojë se operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të nevojshme për menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin korrekt të të gjitha proceseve që lidhen me furnizimin dhe instalimin e sistemit të gazit. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për 1 (një) Inxhinier Naftë dhe Gaz dhe 1 (një) Inxhinier Mekanik është në përputhje të drejtë me natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat e kontratës dhe përbën minimumin e nevojshëm profesional për garantimin e realizimit me sukses të objektit të prokurimit.

3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën si më poshtë:

- a) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose

ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.

*Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë një sistem të certifikuar të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, të vërtetuar nëpërmjet paraqitjes së certifikatës **SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001:2018 (ose versionit të përditësuar SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001:2023)**, ose ekuivalentit të saj. Objekti i këtij prokurimi përfshin jo vetëm furnizimin e pajisjeve, por edhe transportin, shkarkimin, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të një sistemi furnizimi me GLN (Gaz i Lëngëzuar i Naftës), rezervuarëve të gazit, kaldajave dhe pajisjeve të tjera të lidhura me impiante që operojnë nën presion. Këto procese shoqërohen me rreziqe të shtuara për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, duke përfshirë punimet me pajisje nën presion, saldimit të tubacioneve, operimin e pajisjeve mekanike, si dhe manipulimin e lëndëve me potencial rreziku. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor gjykon se disponimi i një sistemi të certifikuar të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë përbën një garanci objektive që operatori ekonomik zbaton procedura dhe masa të organizuara për identifikimin, vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve në punë, si dhe për mbrojtjen e personelit të angazhuar në realizimin e kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të kontratës, nivelin e riskut që paraqesin aktivitetet e instalimit dhe vënies në funksion të impianteve të gazit, si dhe nevojën për të garantuar realizimin e kontratës sipas standardeve të sigurisë dhe cilësisë. Kërkesa që certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, synon të sigurojë vlefshmërinë dhe besueshmërinë e certifikimit të paraqitur. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, paraqitja e certifikatës nga secili anëtar i bashkimit është e nevojshme pasi secili prej tyre merr pjesë në realizimin e kontratës dhe duhet të garantojë standardet e kërkuara të shëndetit dhe sigurisë në punë për aktivitetet që do të kryejë.

*Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për paraqitjen e certifikatës **ISO 45001:2018 / ISO 45001:2023 ose ekuivalente** është proporcionale, e lidhur ngushtë me objektin e prokurimit dhe e nevojshme për të garantuar realizimin e kontratës në kushte sigurie, në mbrojtje të punonjësve, përdoruesve të objektit dhe interesit publik.*

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Në zbatim të nenit 36 dhe nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, specifikimet teknike janë hartuar mbi bazën e projektit teknologjik të përgatitur nga projektues i licencuar dhe preventivit përkatës, me qëllim garantimin e furnizimit, transportit, instalimit, testimin dhe vënies në funksion të impiantit të furnizimit me GLN dhe sistemit të ngrohjes së objektit. Kërkesat e përcaktuara përfaqësojnë parametrat minimalë teknikë të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe nuk kanë si qëllim kufizimin e konkurrencës apo favorizimin e operatorëve ekonomikë të veçantë.

KAPITULLI I

Rezervuari i GLN dhe aksesorët e tij

Kërkesat për rezervuarin e GLN-së dhe pajisjet shoqëruese janë përcaktuar bazuar në projektin teknologjik, pasi objekti i prokurimit ka si element kryesor furnizimin me Gaz të Lëngëzuar të Naftës për sistemin e ngrohjes. Rezervuari horizontal nëntokësor, aksesorët e kontrollit dhe sigurisë, si matësi i nivelit, manometri, valvolat e sigurisë, mbushjes dhe shkarkimit, përbëjnë komponentë të domosdoshëm për magazinimin e sigurt dhe funksionimin normal të impiantit. Po kështu, infrastruktura ndihmëse, që përfshin gërmimet, bazamentin, armaturën dhe strukturat mbrojtëse, është e nevojshme për vendosjen dhe funksionimin e sigurt të rezervuarit sipas projektit të miratuar.

KAPITULLI II

Sistemi i reduktimit të presionit dhe sigurisë

Kërkesat për rregullatorët e presionit, valvolat e sigurisë, elektrovalvolat, filtrat, manometrat dhe pajisjet e tjera të kontrollit janë të lidhura drejtpërdrejt me garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me gaz të kaldajës. Sistemi i reduktimit të presionit është pjesë thelbësore e impiantit, pasi siguron uljen dhe stabilizimin e presionit të GLN-së sipas parametrave të kërkuar të funksionimit. Gjithashtu, kërkesa për sensorët e gazit, alarmet vizuale dhe zanore, si dhe komandimin automatik të elektrovalvolës, lidhet me nevojën për mbrojtjen e objektit dhe përdoruesve nga rrjedhjet e mundshme të gazit dhe përmbushjen e standardeve të sigurisë për impiantet me GLN. Avulluesi i gazit është kërkuar pasi projekti parashikon funksionimin e sistemit nëpërmjet avullimit të kontrolluar të gazit dhe furnizimit të vazhdueshëm të pajisjeve të konsumit.

KAPITULLI III

Kaldaja dhe djegësi

Kaldaja dhe djegësi përbëjnë komponentët kryesorë të prodhimit të energjisë termike dhe realizimit të funksionit për të cilin po kryhet investimi. Parametrat e kërkuar janë përcaktuar në përputhje me llogaritjet teknike të projektit dhe nevojat reale të objektit për ngrohje. Kërkesat për sistemet e kontrollit, sigurisë, automatizimit dhe rendimentit energjetik synojnë garantimin e funksionimit efikas, ekonomik dhe të sigurt të sistemit. Po kështu, kërkesa që djegësi të jetë i pajtueshëm me kaldajën e ofertuar është e nevojshme për të garantuar funksionimin e integruar dhe performancën optimale të impiantit.

KAPITULLI IV

Sistemi hidraulik i ngrohjes

Kërkesat për tubacionet, kolektorët, pompat, enët e zgjerimit dhe radiatorët janë përcaktuar nga projekti teknik dhe janë të domosdoshme për shpërndarjen e energjisë termike në ambientet e objektit. Përdorimi i tubacioneve të përshtatshme për temperaturat dhe presionet e funksionimit, kolektorëve shpërndarës, pompave qarkulluese dhe enëve të zgjerimit garanton funksionimin e sigurt dhe efikas të sistemit të ngrohjes. Radiatorët dhe aksesorët përkatës janë përcaktuar në funksion të ngarkesës termike të objektit dhe janë pjesë integrale e sistemit që do të furnizohet dhe vihet në funksion.

KAPITULLI V

Sistemi elektrik dhe automatizimi

Kërkesat për instalimet elektrike, panelet e kontrollit, kontaktorët, reletë e mbrojtjes dhe sistemet e automatizimit janë të nevojshme për funksionimin e kontrolluar dhe të sigurt të impiantit. Automatizimi mundëson monitorimin dhe komandimin e kaldajës, pompave dhe pajisjeve të sigurisë, duke garantuar stabilitet operacional dhe ndërhyrje automatike në rast anomalish. Kërkesat për tokëzimin dhe mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë e instalimit dhe mbrojtjen e pajisjeve nga efektet e energjisë elektrike dhe elektricitetit statik, veçanërisht në impiantet që përdorin GLN.

KAPITULLI VI

Testimet, kolaudimi dhe certifikimi i impiantit

Kërkesat për testimin, kolaudimin dhe certifikimin e impiantit janë përcaktuar për të garantuar se instalimi është realizuar në përputhje me projektin, standardet teknike dhe kërkesat e sigurisë në fuqi. Testet e hermeticitetit, presionit, funksionalitetit të sensorëve, elektrovalvolave, kaldajës, sistemit hidraulik dhe tokëzimit janë të nevojshme për të verifikuar sigurinë dhe performancën e impiantit përpara marrjes në dorëzim. Kërkesa për paraqitjen e certifikatave CE, deklaratave të konformitetit, certifikatave PED ose ekuivalente dhe certifikimit përfundimtar të impiantit nga subjekte të autorizuar synon të garantojë që të gjitha pajisjet dhe sistemi në tërësi përmbushin standardet teknike dhe ligjore në fuqi.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike të mësipërme janë në përpjesëtim të drejtë me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e objektit të prokurimit, janë të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e kontratës dhe përfaqësojnë kërkesat minimale të nevojshme për furnizimin, instalimin dhe vënien në funksion të sistemit të furnizimit me GLN dhe sistemit të ngrohjes, pa kufizuar konkurrencën dhe duke lejuar ofertimin e produkteve dhe pajisjeve ekuivalente që përmbushin ose tejkalojnë parametrat e kërkuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT:

Kristina Zaçellari

Sonjela Zguri

Marsela Tërova